



KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

NË KONTROLLIMIN EKSTERN NUK LEJOHET:

- ▶ VONESA, PREZANTIMI I RREJSHËM DHE LARGIMI NGA KLASA GJATË PROVIMIT,
- ▶ HAPJA E LIBREZËS SË TESTIT PARA KOHËS SË LEJUAR,
- ▶ NDËRRIMI I KLASËS DHE NUMRIT TË VENDIT TË PUNËS,
- ▶ SHKRIMI/VIZATIMI I ASAJ QË NUK KËRKOHET NË DETYRA DHE GRISJA E FLETAVE TË LIBREZËS SË TESTIT,
- ▶ MOSRESPEKTIMI I SHENJËS PËR FILLIMIN DHE PËRFUNDIMIN E KONTROLLIMIT TË NJOHURIVE TË NXËNËSVE

ME RËNDËST!!! ▶▶▶

- ▶ Nëse nxënësi nuk respekton rregullat në vijim: pengon nxënësin tjetër, kthehet, bisedon, përkatësisht merret vesh në mënyra të ndryshme dhe ngjashëm, nuk u përmbahet udhëzimeve të cilat ua jep administruesi i testit, ai nxënës do të paralajmërohet. Nëse përsëri do t'i tërhiqet vërejtja do të largohet nga provimi dhe konsiderohet se nuk e ka dhënë atë provim.
- ▶ Nëse nxënësi tenton ta ndërpres provimin, ofendon apo e kërcënon administruesin e testit ose përfaqësuesin e Qendrës së Provimeve, posedon mjete të palejuara (letër, tekst shkollor, telefon celular ose ndonjë pajisje tjetër elektronike dhe ngjashëm), shkel sekretin e identitetit duke u nënshkruar me emër dhe mbiemër të plotë ose në ndonjë mënyrë tjetër, përshkruan nga nxënësi tjetër apo i mundëson nxënësit tjetër që të përshkruaj, përjashtohet nga provimi dhe konsiderohet se atë provim nuk e ka dhënë.

- ▶ Duhet të jesh para klasës së caktuar 30 minuta para fillimit të punës.
- ▶ Vendi ku je ulur është i shënuar me numra dhe i përcaktuar sipas renditjes në listë.
- ▶ Kur ta marrësh testin, vendose atë në skaj të bankës dhe përcilli udhëzimet e administruesit të testit.
- ▶ Përgjigjja përfundimtare duhet të jetë e shkruar qartë.
- ▶ Përdor vetëm mjetet që janë të lejuara për atë lëndë.
- ▶ Nëse gabon, kryqëzoje zgjidhjen e gabuar dhe zgjidhe atë përsëri.

- ▶ ËSHTË SHUMË E RËNDËSISHME QË ZGJIDHJEN E DETYRËS/PYETJES TA SHKRUASH NË VENDIN E PARAPARË PËR ATË DETYRË/PYETJE, BRENDA HAPËSIRËS SË CAKTUAR, SEPSE PËRNDRYSHE NUK DO TË SHQYRTOHET.
- ▶ NËSE PËRFUNDON MË HERËT, DUKE NGRITUR DORËN NJOFTO ADMINISTRUESIN E TESTIT, QË TË MOS PENGOSH PUNËN E NXËNËSVE TË TJERË, DORËZO PUNIMIN TËND DHE NË HESHTJE LARGOJU NGA SHKOLLA.